



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
KUÇOVË

Nr. 3306 Prot.

Kuçovë, më 28.10. 2022

V E N D I M

Nr. 66 datë: 25 / 10 /2022

“Për një ndryshim të vendimit nr. 30 datë 21.04.2021, për vlerësimin e drurëve frutor që gjenden në sipërfaqen që do të shpronësohet në parcelën e fermerëve bashkëpronar Nebi Troka dhe Nazire Troka, të cilët preken nga projekti i Zgjerimit të Varrezave Publike të Njesisë Administrative Perondi, fshati Tapi”

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 25 / 10 /2022, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Kuçovë, Z. Kreshnik Hajdari, pasi u njohë me materialin e paraqitur nga ana e grupit të punës për shpronësim, ku referuar ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar si dhe mbështetur në ligjin nr. 8561 datë: 22.12.1999 “Për Shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publike” i ndryshuar, në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji. VKM - së nr .127.datë: 23.03.2000 “Për përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njoftimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë prone private për ineters publik”, V.K.M - së nr.138 datë: 23.03.2000 “Për kriteret e llogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë për interes publik”, i ndryshuar,

V E N D O S I

1. Miratimin e ndryshimit të vendimit nr. 30 datë 21.04.2021, për vlerësimin e drurëve frutor që gjenden në sipërfaqen që do të shpronësohet në parcelën e fermerëve bashkëpronar **Nebi Troka dhe Nazire Troka**, të cilët preken nga projekti i Zgjerimit të Varrezave Publike të Njesisë Administrative Perondi, fshati Tapi”
2. Miratimin e masës së dëmshpërblimit referuar Proçes – Verbalit për shpronësimin e qytetarëve bashkëpronarë që janë prekur nga zbatimi i projektit “ Zgjerimi i Varrezave Publike të Njesisë Administrative Perondi fshati Tapi” konkretisht për subjektin si më poshtë:
 - **Nebi Yzeir Troka/ Nazire Janus Troka** , disponojnë pasurinë me nr. 1280/56 zona kadastrale 3561, me sipërfaqe shpronësimi 560 m² lloji i

pasurisë Arë si dhe shpronësimi i drurëve frutor për të cilën është mbajtur dhe një Proçes – Verbal me vlerën **58.584** që gjenden në këtë sipërfaqe shpronësimi.

Vlera totale e shpronësimit është, **232,744 (dyqind e tridhjetë e dy mijë e shtatqind e dyzet e katër) lekë.**

3. Ngarkohen me zbatimin e këtij vendimi grupi i punës ngritur me urdhërin e brendshëm numër 244 datë 20.09.2022 “ Për një ndryshim të urdhërit të brendshëm nr.80 datë 09.03.2018 “ Për Krijimin e Komisionit të Shpronësimeve, për zgjerimin e Varrezave Publike” në fshatin Tapi, Njësia Administrative Perondi dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 pas shpalljes.

Ky vendim u miratua 19 vota pro; — kundër; ~ abstenim;

19 këshilltarët prezent.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Migena BULLARI

